



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 21.7.2023, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Sami Boroci (AKR) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Fehmi Kupina, anëtar i pavarur, Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Tria Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR) dhe Agim Kuleta (LB).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Arta Balaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi anëtari më i moshuar i Kuvendit, Ajet Brajshori.  
Ai propozoi këtë

Faqe 1 nga 3

## Rend të ditës:

### 1. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 26 vota për, u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Ajet Brajshori, kryesues i mbledhjes, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth procedurës së zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit, duke cekur se votimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës bëhet me vota të fshehta. Për zgjedhjen e kryesuesit duhet të themelohet një komision, në përbërje prej tre anëtarëve të Kuvendit, i cili ka për detyrë që të mbikëqyrë procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit.

Jeta Rafuna, për anëtare të komisionit propozoi Lindita Rexhepin;

Leutrim Retkoceri, për anëtar të komisionit propozoi Agron Canollin;

Sami Boroci, për anëtar të komisionit propozoi Endrit Zabërgjën.

Jeta Rafuna, për kryesues të Kuvendit, propozoi Pëllumb Bajçinovcin.

Kryesuesi, filloi me procedurën e votimit për kryesues të Kuvendit.

*Lindita Rexhepi, anëtare e komisionit, bëri të ditur se në votim kanë marrë pjesë gjithsejtë 26 anëtarë të Kuvendit dhe komisioni konstaton se njëzëri, më 26 vota për, Pëllumb Bajçinovci zgjidhet kryesues i Kuvendit të kryeqytetit.*

Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë për zgjedhjen kryesues të Kuvendit. Ai tha se me mbështetjen e secilit prej jush, do të angazhohem që të kemi solidaritet dhe bashkëpunim të sinqertë, secilën herë që kemi çështje që i lidhin interesat tona të përbashkëta për ta transformuar Prishtinën, për të mirën e qytetarëve të saj, pa dallim. Po ashtu, u ofroj bashkëpunim të sinqertë dhe të pazezervë secilit anëtar të këtij Kuvendi, të gjitha komiteteve, dhe secilit anëtar të kabinetit të Kryetarit të Kryeqytetit.

Përparim Rama, kryetar, tha se është kënaqësi e veçantë me qenë sot këtu për të përruruar zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pëllumb Bajçinovcin tashmë e njoh, e njoh personalisht puna e tij, që ka qenë dhe vazhdon të jetë e mrekullueshme. Është një njeri unifikues dhe i palodhshëm në shumë fusha, si në art, kulturë e shumë fusha të tjera.

Pëllumbi ka qenë gjithmonë aktiv. Përveç si asamblist, ai ka dhënë kontribut edhe me elemente të ndryshme, të cilat vetëm se e kanë begatuar jetën në kryeqytet.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:45.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i mbledhjes  
Pëllumb Bajçinovci**



---

Faqe3nga3